

STATUTI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“TurboSoft” sh.p.k

Kreu I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

FORMIMI I SHOQËRISË

Neni 1

a. Sot në Tiranë në datën 27/08/2019 themelohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar “TurboSoft” shpk, me vullnetin e lirë të ortakëve, në bazë të ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, formohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “**TurboSoft**” shpk, nga ortakët themelues:

1. **ADEM ADEMI**, shtetas Maqedonas, i datëlindjes 13-11-1978 lindur në Palçisht i Poshtëm dhe banues në Tirane, Njesia Bashkiake nr.10 Rruga Him Kolli, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, me nr ID 1311978470008.

b. Të cilët me vullnetin e tyre të lirë dhe në përputhje me Ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", si dhe Aktin e Themelimit, kanë vendosur të destinojnë në këtë sipërmarrje kapitalin e tyre, me qëllim që të përfitojnë të ardhurat që mund të vijnë nga veprimtaria private e Shoqërisë, si dhe të përballojë humbjet deri në kufirin e vlerës së kontributit në Kapitalin Themeltar.

c. Shoqëria ushton veprimtarinë e saj në bazë të ekonomisë së tregut të lirë. Shoqëria tregtare “TurboSoft” SHPK., fiton Personalitet Juridik nga dita e rregjistrimit të saj pranë zyrës së Qendrës Kombëtare të Biznesit.

FORMA DHE EMËRTIMI I SHOQËRISË

Neni 2

1. Shoqëria tregtare, është e organizuar si *Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar*.

2. Emërtimi i Shoqërisë është: “TurboSoft” SHPK.

3. Në rast transferimi të veprimtarisë tregtare, mund të ruhet i njëjtë emërtim, me kusht që Personi Juridik të shtojë në këtë emërtim një shënim i cili ka të bëjë me transferimin.

SELIA E SHOQËRISË

NENI 3

1. Shoqëria tregtare “TurboSoft” SHPK., ka selinë qendrore në territorin e Republikës së Shqipërisë në qytetin e Tirane, Njesia Bashkiake Nr.10, Rruga e Durresit, Pallati Nr.11. Hyrja 5. Kati 1. Ap.34.

2. Shoqëria mund të krijojë qendra sekondare, filiale, zyra përfaqesimi apo agjensi në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.

3. Ajo mund të jetë pjesëmarrëse në një shoqëri tregtare apo mund të kontrollojë shoqëri të tjera tregtare si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

4. Njësitat strukturore të shoqërisë në format e mësipërme do të krijohen në perputhje me legjislacionin Shqiptar kur ndodhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, dhe jashtë saj në përputhje me legjilacionin e vendit ku Personi Juridik ka qendrën e tij.

5. Shoqëria do të ketë vulenë e saj.

KOHËZGJATJA

Neni 4

1. Shoqëria Tregtare “TurboSoft” SHPK., do të përbushë objektin e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar.

2. Ndryshimet e shoqërisë duke përfshire edhe përcaktime të mëvonshme në lidhje me kohëzgjatjen e aktivitetit të saj nuk sjellin si pasojë krijuimin e një Personaliteti të ri Juridik.



OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Neni 5

Objekti i shoqerise "TurboSoft" SHPK do të jetë:

Prodhim programe kompjuterike. Zhvillimin e sistemeve kompjuterike.

TË DREJTATE SHOQËRISË

Neni 6

Shoqeria tregtare "TurboSoft" SHPK., nuk pergjigjet per detyrimet qe rrjedhin nga veprimtaria ekonomiko-tregtare apo industriale qe ortaket zhvillojne në menyre të pavarur prej saj.

Shoqeria mund të ndryshoje emrin, seline, kohezgjatjen, objektin e veprimtarise, administratorin, sipas vendimeve qe do të marrin ortakët.

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 7

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 100.000 lekë (Nje qinde mijë leke), i cili është tërësisht kapital financiar. Kapitali themeltar është 1 kuote me vlerë nominale 100.000 lekë.

Kapitali themeltar zotërohet nga:

1. **ADEM ADEMI**, zotërues i 1 (një) kuote apo 100 % të kapitalit të shoqërisë.

Ortakët kanë të drejtë të tjetërsojne, të zmadhojne apo të pakësojnë kuotat e kapitalit deri në kufijtë e përcaktuara nga ligji. Kapitali filletar nuk është paguar.

NENI 8

Shoqeria krijon fondin rezerve dhe fonde të tjera të veçanta të financimit per zhvillimin ekonomik e tregtar.

NENI 9

1. Perberja e kapitalit të shoqerise, fonde e krijuar të saj si dhe përdorimi e rregullimi i çdo foni të veçante përcaktuara nga Ortakët sipas të drejtave dhe detyrate të përcaktuara në statut.

2. Të ardhurat e pergjitheshme të shoqerise dhe në per gjithësi çdo operacion financiar i saj do të pasqyrohet në kontabilitetin e shoqerise sipas legjislacionit në fuqi dhe në mbeshtetje të akteve perkatese të rrjedhura prej tij.

NENI 10

1. Shoqeria Tregetare "TurboSoft" SHPK., eshte pronare e pasurise së saj të cilën e përdor dhe e disponon në emer të saj në perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise së shoqerise.

2. Shoqeria eshte e lire të bleje dhe të shfrytezoje të drejtë të tjera materiale në perputhje me legjislacionin perkates shqiptar.

3. Të gjitha shpenzimet per ushtrimin e aktivitetit tregtar, asistencë teknike e juridike paguhën nga fonda e shoqerise.

NENI 11

1. Pasurite e shoqerise vleresohen në monedha shqiptare.

2. Aktiviteti financiar i shoqerise do të mbyllët me 31 Dhjetor të çdo viti dhe bilanci do të miratohet brenda tre muajve të vitit në vazhdim.

3. Llogarite vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar, raportet e veçanta të hartuara nga Ortakët dhe nëse e kërkon ligji nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen me Vendim të Ortakeve të saj.

NENI 12

Pjeset e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashegimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarje pasurore midis bashkeshorteve si dhe ndermjet pasardhesve dhe paraardhesve.

NENI 13

Transferimi i pjesave të kapitalit themeltar me trashegimi ose brenda familjes personave perfittues do të behet pasi ata të pranojnë permbajtjen e statutit të kesaj shoqerie tregtare me gjithe ndryshimet qe ai mund të kete pesuar deri në momentin qe keto pjesa të kapitalit themeltar behen të transferueshme.

NENI 14

Ne rast mospranimi, pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të trete qe nuk befne pjesë në shoqeri vetem me miratimin e Ortakeve.

NENI 15

Zmadhimi i kapitalit themeltar me anen e kontributeve në para dhe në natyre apo i zvogelimi i tij behet me Vendimin e Ortakeve të shoqerise mbi bazen e nje projekti të paraqitur nga ekonomisti i firmës ose kontabli i miratuar.

KREU I DYTË

ORTAKËRIA

NENI 16

Ortakët e shoqërisë tregtare "TurboSoft" SHPK., gëzojnë të gjitha të drejtat dhe marrin përsipër detyrimet që pasqyrohen në legjislacionin e Republikës së Shqiperise, në Aktin e Themelimit dhe në Statutin e Shoqerise.

Te drejtat dhe detyrat e Ortakeve

NENI 17

1. Të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve duke ushtruar të drejtën e votës së tij;
2. Të paraqesë pyetje me shkrim në lidhje me aktivitetin dhe administrimin e shoqërisë ndaj administratorit;
3. Të informohet mbi përbajtjen e raportit të administrimit, inventaret e llogaritë vjetore, tekstet e vendimeve të propozuara, dhe raportin e ekspertit kontabël;
4. Të përfitojë nga fitimi i shoqërisë;
5. Të kërkojë prishjen e shoqërisë në rrethana të caktuara;

KREU I TRETË

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 18

1. Sipas nevojave që paraqiten për zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë, asambleja e ortakëve emëron dhe punëson administrator dhe drejtues teknik , të cilët qëndrojnë në detyrë deri sa revokohen nga shoqëria ose largohen me dëshirën e tyre. Administratori i emëruar i ka të gjitha kompetencat për të vepruar në emër të shoqërisë me përfashtim të rasteve të veçanta që ligji i jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.
2. Shoqëria do të administrohet nga administratori **ADEM ADEMI**, i cili përfaqëson shoqerinë në marrëdhënet me të tretët për një periudhë 5 (pesë) vjecare dhe me të drejtë rizgjedhje.
3. Administratori mund t'i delegojë kompetencat e tij me shkrim në formen e autorizimit ose me prokurë.
4. Shoqëria në të ardhmen mund të administrohet dhe nga nje administrator tjeter, i cili emërohet me Vendim të Ortakëve.

ASAMBLEJA

NENI 19

1. Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë.
2. Ortakët mund t'i delegojnë kompetencat e tyre me shkrim në formën e autorizimit ose me prokurë.
3. Çdo klauzolë e kundërt është e pavlefshme në këtë rast.

Asambleja e Ortakëve ka të drejtë :

1. Të hartojë e miratojë ndryshimet në Statut;
2. Të miratojë bilancin vjetor të shoqërisë
3. Të vendosë për zmadhimin apo zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
4. Të emërojë dhe shkarkojë administratorin e shoqërisë;
5. Të shpallë prishjen, likujdimin dhe falimentimin e shoqërisë;
6. Të shprehet për kohëzgjatjen e shoqërisë;
7. Të miratojë marrëveshjet e arritura në qarkullimin civil të saj;
8. Të miratojë strukturat e shoqërisë etj.;
9. Çdo vendim tjetër që i njihet nga ligji, Akti i Themelimit të shoqërisë dhe Statutit të saj.
10. Proces verbalet e mbledhjeve ruhen në selinë e shoqërisë.

TË DREJTAT E ADMINISTRATORIT

Administratori ka këto të drejta:

1. Të përfaqësojë shoqerinë në marrëdhëniet e saj me të tretët, e në administratën publike ;
2. Të emërojë pranë shoqërisë personelin e domosdoshëm që i nevojitet asaj në përbushjen e aktivitetit tregtar dhe ekonomik;
3. Të paraqesë për miratim në Asamblenë e Ortakëve strukturën e brendshme organizative të shoqërisë me emra përkatës dhe të përbushë të gjitha detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni i punës Republikës së Shqipërisë;
4. Të administrojë pasurinë dhe mjetet financiare të shoqërisë brenda kufijve të caktuara nga Asambleja e Ortakëve;
5. Të testojë aftësitë e punonjësve në administratë;
6. Të thërrasë Asamblene e Ortakëve dhe të propozojë çështjet që duhen analizuar;
7. Të hartojë objektivat e shoqërisë për çdo vit pasues dhe të vendosë e të ndjekë realizimin e detyrave të lëna nga Vendimet e marra nga Ortakët;
8. Të hartojë planet e llogarive ekonomike dhe t'i paraqesë ato për miratim nga Asambleja e Ortakëve.

Administratori është përgjegjës individualisht sipas rastit ndaj vetë shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

1. Shoqëria organizon kontrollin e brendshëm me ekonomist të licencuar dhe kur kërkohet nga ligji me një ekspert kontabël të autorizuar, të cilët janë përgjegjës për problemet që mund të shkaktojnë nga moskryerja në rregull e detyrës së tyre.
2. Për emërimin, kompetencat, detyrimet, përgjegjësitë, zëvendësueshmërinë, tërheqjen, shkarkimin dhe shpërblimin e tij zbatohet legjislacioni Shqiptar në fuqi.

1. Të gjithë personat që do të punësohen pranë kësaj shoqërie, punësimi i tyre do të bëhet mbi bazën e kontratës individuale apo kolektive, sipas rastit, në të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet ligjore të secilës palë si dhe paga mujore në perputhje me legjislacionin shqiptar në këtë fushë.
2. Marrja në punë bëhet me rregjistrimin nga punëdhënësi në Librin e Punës së Shoqërisë, si dhe duke njoftuar organet e Punës së Juridikzonit ku ushtron aktivitetin Shoqëria.
3. Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punës, bëhet në bazë të një akti me shkrim të lëshuar nga Administratori. Largimi lidhet me mbarimin e kontratës së punës për shkak të shkeljeve disiplinore ose me kërkesën e të interesuarit. Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së Shoqërisë, do të zgjidhen me mirëkuptim të palëve, të cilat për këtë qëllim mund të caktojnë nga një përfaqësues me prokurë. Kur mirëkuptimi nuk është i mundur, palët i drejtohen Gjykatës të Rrethit Gjyqësor.

FORCAT MADHORE

Ortakët nuk mbajnë përgjegjësi kur ka paaftesi paguese pjesore apo të plotë për kryerjen e detyrimeve të tij kur kjo është si pasoje e rrëthanave të forcave madhore që vërtetohen pas nënshkrimit të kontratës dhe ortakët nuk mund ti shmangen me masa të arsyeshme. Ngjarje të forcave madhore janë ato që i shpëtojnë kontrollit të ortakëve.

Kur ortakët ndodhen në paaftesi të plotësojnë detyrimet e tij për arsyet e forcave madhore, në bazë të kontratës dhe statutit duhet të bëjnë cdo përpjekje që ta kapërcejnë këtë vështirësi.

SHPËRNDARJA E SHOQËRISË
NENI 26

Shpërndarja e shoqërisë mund të vijë në cdo kohë dhe për çfarëdo shkaku.

Shoqëria mund të prishet para kohe;

-Me vendim të ortakëve.

-Kur mbaron kohëzgjatja e shoqërisë.

-Pas dy vjetëve të veprimitarisë me bilanc negativ(Humbje).

-Me vendim të gjykatës ose për arsyen të tjera të parashikuara në statut.

Në rast mbyllje ortakët vendosin mbi mënyrat e likujdimit dhe caktojnë një ose më shume likujditarë duke ju përcaktuar dhe detyrat.

Në rastin e likujdimit emërtimi i shoqërisë do të shoqërohet nga shënim " Shoqëri në likujdim".

Mbasi bëhet njoftimi i mbylljes së likujdimit dhe kryen formalitetet e duhura, shoqëria çregjistrohet nga regjistri tregtar i Qendrës Kombëtare të Biznesit.

BAZA LIGJORE

Neni 27

E gjithë veprimitaria e shoqërisë do të bazohet në ligjin 9901 date 14.04.2008 " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" si dhe në përgjithësi në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

RUAJTJA E SEKRETIT

Neni 28

Ortakët detyrohen që të mos nxjerrin tek të tretët të dhëna dhe njoftime sekrete që kanë të bëjnë me veprimitarinë ekonomike të shoqërisë.

Ortakët e shoqërisë përcaktojnë llojin e të dhënavës dhe informatave që konsiderohen sekrete.

DISPOZITA TË FUNDIT

NENI 29

Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut do të aplikohet Ligji "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare" si dhe Legjislacioni Shqiptar në fuqi.


NENI 30

Ky Statut hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqerisë në Rregjistrin Tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

NENI 31

Ky Statut përpilohet në 5 kopje origjinale secili me të njëjtën vlerë ligjore. Njëri prej tyre ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

**ORTAKU i Vetëm
ADEM ADEMI**



AKTI I THEMELIMIT

PËR SHOQËRINË "TurboSoft" SHPK

FORMIMI I SHOQËRISË

Sot në Tiranë në datën 27/08/2019 themelohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar "TurboSoft" shpk, me vullnetin e lirë të ortakëve:

1. ADEM ADEMI, shtetas Maqedonas, i datëlindjes 13-11-1978 lindur në Palçisht i Poshtëm dhe banues në Tirane Njesia Bashkiake nr.10 Rruga Him Kolli, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, me nr ID 1311978470008.

SELIA E SHOQERISE

1. Shoqëria tregtare "TurboSoft" SHPK., ka selinë qendrore në territorin e Republikës së Shqipërisë në qytetin e Tirane, Njesia Bashkiake Nr.10, Rruga e Durrësit, Pallati Nr.11. Hyrja 5. Kati 1. Ap. 34. por me vendim të ortakëve të shoqërisë, mund të ngrihen edhe filiale, degë apo dhe seli përfaqësimi në vende të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë.

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

1. Shoqëria Tregtare "TurboSoft" SHPK., do të përbushë objektin e veprimitarisë së saj me një afat të pacaktuar.
2. Ndryshimet e shoqërisë duke përfshire edhe përcakttime të mëvonshme në lidhje me kohëzgjatjen e aktivitetit të saj nuk sjellin si pasojë krijimin e një Personaliteti të ri Juridik.

KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 100.000 lekë (Nje qinde mijë leke), i cili është tërësisht kapital finanziar. Kapitali themeltar është 1 kuote me vlerë nominale 100.000 lekë.

Kapitali themeltar zotërohet nga:

1. ADEM ADEMII, zotërues i 1 (një) kuote apo 100 % të kapitalit të shoqërisë.

Ortakët kanë të drejtë të tjetërsojne, të zmadhojnë apo të pakësojnë kuotat e kapitalit deri në kufijtë e përcaktuara nga ligji.

Kapitali fillestari nuk është paguar.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË:

Objekti i veprimitarisë së shoqërisë "TurboSoft" shpk do të jetë :

Prodhim programe kompjuterike. Zhvillimin e sistemeve kompjuterike.

Me zgjerimin e aktivitetit shoqeria mund te beje shtesa te ndryshme ose ndryshime te objektit te veprimitarise se saj duke bere ndryshimet perkatese ne statut.

ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

1.Organi drejtues i shoqërisë është asambleja e përgjithshme e ortakëve e cila është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështje të mëposhtme :

- a- për ndryshime në statut
- b-emërimin dhe shkarkimin e administratorit
- c-miratimin e bilancit dhe të pasqyrave financiare vjetore.
- d- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit
- e-riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

2.Administratori i përgjithshëm i shoqërise , është **ADEM ADEMI** me afat 5 vjeçar me te drejtë ripërtëritje.

BAZA LIGJORE

E gjithë veprimtaria e shoqërisë do të bazohet në ligjin "9901 date 14.04.2008" Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare " si dhe në legjislacionin në përgjithësi të Republikës së Shqipërisë.

Ky Akt Themelimi u nënshkrua në pesë kopje të barasvlefshme të tij. Njëri prej tyre ruhet në selinë e shoqërisë.

ORTAKU i Vetëm

ADEM ADEMI

